



RAPORT MONITORIMI

GJYKATA KUSHTETUESE

Analizë e Vendimeve





Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese: Analiza e vendimeve më të rëndësishmë të saj

Gjykata Kushtetuese plotësoi kuorumin e saj të anëtarëve për të ushtruar funksionet e saj në dhjetor të 2020. Ajo nuk mundi të ushtronte funksionet e saj për gati dy vite.

Për shkak të dorëheqjes së anëtarëve të saj dhe për shkak të shkarkimit nga procesit të vetingut, Gjykata Kushtetuese mbeti vetëm me një anëtar.¹

Kushtetuesja është gjykata më e rëndësishme në vend për shkak të çështjeve me të cilat ajo merret.²

Kontrulli kushtetues i ushtruar përmes Gjykatës Kushtetuese është një nga faktorët e rëndësishëm që ndikon në konsolidimin e shtetit të së drejtës. Kushtetuta mund të çënohet nga ligje që bien në kundërshtim me dispozitat e saj, por ajo mund të çënohet edhe në frymën, dhe vlerat themelore që ajo shpreh dhe mbron.



Është pikërisht kjo gjykatë e cila shërben si mekanizëm për garantimin e ndarjes së pushteteve, e të drejtave të njeriut dhe parimeve themelore mbi të cilat ngrihet shteti shqiptar.

¹ <https://ëëë.reporter.al/si-u-rrezua-gjykata-kushtetuese/>

² Për më shumë shih nenin 131 të Kushtetutës

Përgjatë mungesës së saj, në vend u krijuan përplasje mes institucionesh, Kuvendi miratoi ligje të cilat shkelnin Kushtetutën dhe të drejtat e njeriut, u zhvilluan për herë të parë zgjedhje lokale me një parti në shumicën e bashkive etj.

Me emërimin e anëtarëve të saj, Gjykata nisi të shqyrtonte të gjitha çështjet të depozituara pranë saj gjatë mungesës së saj.

Raporti synon të analizojë disa nga vendimet në lidhje me çështjet më të rëndësishme në vend si:

- Mosmarrëveshja mes Presidentit Ilir Meta dhe Kryeministrit Edi Rama në lidhje me emërimin e një ministri



- Kushtetutshmëria e ligjit për ndërtimin e Teatrit Kombëtar



- Kushtetutshmëria e vendosjes së pragut të herësit në Kodin Zgjedhor



- Kushtetutshmëria e ndryshimeve të ligjit për policinë



- Kushtetutshmëria e nenit 262 të Kodit Penal, në lidhje me lirinë e tubimeve



Raporti synon të paraqesë faktet e çështjeve, shkurtimisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese si dhe komente në lidhje me rëndësinë e këtyre vendimeve.



Mosmarrëveshja mes Presidentit Ilir Meta dhe Kryeministrit Edi Rama në lidhje me emërimin e një ministri

Faktet

Në dhjetor të 2018, Kryeministri Edi Rama shkarkoi nga detyra ish ministrin e Jashtëm Ditmir Bushatin dhe propozoi si pasardhës të tij Gent Cakaj.

Presidenti Ilir Meta refuzoi kandidaturën e këtij të fundit me argumentin se:

“Cakaj ka një mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative dhe shtetërore, në secilin element dhe në tërësi, duke mos krijuar besueshmëri, si dhe garancitë e nevojshme për ushtrimin me objektivitet dhe në lartësinë e kërkuar të detyrës tepër të rëndësishme të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Presidenti ka konstatuar se z. Cakaj ka mbajtur qëndrime publike për korrigjimin e kufijve të Kosovës dhe Serbisë, si dhe Ballkanit Perëndimor, të cilat janë në kundërshtim me programin e qeverisë për politikën e jashtme. Gjithashtu, Presidenti ka konstatuar se z. Cakaj ka ushtruar detyrën e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme për një periudhë 7-mujore pa pasur certifikatën përkatëse të sigurisë për njohjen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, certifikatë me të cilën është pajisur brenda 1 dite pune nga institucioni përgjegjës, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).”

Ndërkohë Presidenti Meta nuk u shpreh në lidhje me shkarkimin e ish ministrit Bushati brenda afatit 7 ditor³.

Në shkurt të 2019, Kryeministri Rama paraqiti një kërkesë në Gjykatë Kushtetuese duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes tij dhe Presidentit Meta.

³ Neni 98 i Kushtetutës: Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve

Vendimi i Gjykatës⁴:

- Procesi i emërimit të ministrit përfshin tre insitucione: Kryeministrin, Presidentin dhe Kuvendin.
- Asnjë insitucion nuk mund të veprojë i vetëm në këtë proces
- Të tre insitucionet duhet të bazohen në parimet e luajalitetit⁵ dhe ndarjes së pushteteve⁶
- Procezin e emërimit apo shkarkimit të një ministri e nis Kryeministri. Kjo sepse ai ka diskrecionin për të propozuar pjesëtarin e ekipit të tij qeverisës. Megjithatë gjykata argumenton se kandidati duhet të plotësojë disa kushtet, të cilat janë të njëjta me ato të qenit deputet⁷.
- Pjesa e dytë e procesit lidhet me dekretin e Presidentit. Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se roli i Presidentit nuk është honorifik por thelbësor. Sipas saj, Presidenti ka rol verifikues në lidhje me kandidatin për ministër. Ai nuk është i detyruar të pranojë propozimin e kryeministrit.
- Kuvendi ka rolin përmbyllës të procesit të emërimit/shkarkimit të ministrit. Kuvendi ka për të detyrë të kontrollojë dekretin e Presidentit. Roli i Kuvendit është korigjues dhe kryen kontroll thelbësor të dekretit.
- Institucionet duhet të respektojnë afatet kohore 7 ditore (Presidenti) dhe 10 ditore (Kuvendi) për të mos krijuar probleme në formimin dhe funksionimin normal të qeverisë.

Analiza e vendimit

Vendimi i GJK është i një rëndësie të veçantë pasi për herë të parë sqaron rolin e tre institucioneve në procesin e emërimit të ministrit. Rëndësia e këtij vendimi qëndron në qartësinë e rolit të Presidentit. Kështu teksa përfaqësues të shumicës socialiste argumentonin në kohën e mosmarreveshjes se Presidenti kishte vetëm kompetenca honorifike, tashmë është e qartë se Presidenti ka të drejtë të kthejë kandidaturën për ministër të propozuar nga Kryeministri nëse ka arsye të justifikuara. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese e detyron Presidentin të argumentojë bazuar në prova dhe fakte rrëzimin e një kandidature për ministër, në mënyrë që procesi të mos kthehet në abuzivitet me kompetencat e këtyre institucioneve.

Ky vendim merr rëndësi të veçantë pasi Presidenti Ilir Meta do të dekretojë ministrat e qeverisë së re të dalë nga zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit.

⁴ Për me shumë lexo Vendimin nr.26 datë 25.05.2021

⁵ Parimi i luajalitetit kushtetues nënkupton se ndërmjet dy organeve kushtetuese, në respekt të kompetencave që i janë dhënë secilit, mund të ekzistojë një marrëdhënie bashkëpunimi, aty ku bashkëpunimi nuk cenon pavarësinë e secilit organ.

⁶ Parimi i ndarjes së pushteteve nënkupton që asnjë institucion apo pushtet nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së institucioneve apo pushtetave të tjera.

⁷ Për më shumë shih nenet 68, 69 dhe 70 të Kushtetutës

Një tjetër element që vlen për tu përmendur në lidhje me këtë vendim është përcaktimi i rolit të Kuvendit. Gjykata Kushtetuese argumenton se Kuvendi duhet të kryejë kontroll thelbësor të dekretit të Presidentit. Dhe së fundmi Gjykata Kushtetuese i kërkon të tre institucioneve të respektojnë afatet kushtetuese të përcaktuar për secalin prej tyre.



Kushtetutshmëria e ligjit për ndërtimin e Teatrit Kombëtar

Faktet:

Në korrik të vitit 2018, qeveria miratoi një ligj, i cili kishte për qëllim të përcaktonte procedurën për ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar. Ligji u miratua në Kuvend, ndërsa Presidenti Ilir Meta e ktheu atë me argumentin se cenonte "parimin e barazisë përpara ligjit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, identitetin dhe trashëgiminë kombëtare, parimin e decentralizimit dhe të autonomisë vendore."

Kuvendi vendosi të rrëzojë dekretin e Presidentit dhe të miratojë ligjin për Teatrin e ri Kombëtar. Presidenti vendosi sërish të mos e dekretojë ligjin për të njëjtat arsye sa më sipër. Kuvendi rrëzoi sërish dekretin e Presidentit Meta. Ligji më pas hyri në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Në korrik të vitit 2019, Presidenti Meta i është drejtuar GJK për të shfuqizuar këtë ligj si në kundërshtim me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Në maj të 2020, qeveria vendosi të kalojë në pronësi të Bashkisë truallin e Teatrit Kombëtar. Presidenti iu drejtua sërish Gjykatës për të shfuqizuar si antikushtetues këtë vendim të qeverisë.

Në 14 maj 2020, Këshilli Bashkiak i Tiranës miratoi shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar. Ndërsa shembja faktike ndodhi në 17 maj 2020.

Vendimi i Gjykatës⁸:

Në vendimin e saj GJK ka analizuar fillimisht ligjin për ndërtimin e Teatrit Kombëtar. Presidenti Meta kishte argumentuar përpara gjykatës se ky ligj cenonte lirinë e veprimitarisë ekonomike.

- Gjykata vendosi se ligji i miratuar në parlament, edhe me rregullimet e bëra⁹ ligji kufizonte të drejtën e kompanive të tjera për të marrë pjesë në këtë procedurë.
- Sipas saj ligji favorizonte kompaninë Fusha sh.p.k. Kjo për dy arsye: kompania Fusha ishte pronare e njërës prej truallit që do të ndërtohej dhe kishte marrëveshje me pronarët e pjesës tjetër ku do të ndërtohej.
- Ekzistenca e këtyre dy fakteve dekurajonte kompanitë e tjera të merrnin pjesë sepse ata duhet të arrinin marrëveshje me vetë kompaninë Fusha sh.p.k.
- Gjykata e konsideroi ligjin jopropocinal dhe në shkelje të Kushtetutës¹⁰

Në lidhje me pretendimin e cenimit të trashëgimisë kulturore dhe identiteti Kombëtar, gjykata argumenton se nuk është kompetente për të analizuar përfshirjen ose jo të një godine në trashëgiminë kulturore të vendit por ajo vëren se:

- Të gjitha institucionet nuk kanë vepruar në përputhje me ligjin për përcaktimin e statusit të godinës së Teatrit Kombëtar.¹¹
- Veprimet e institucioneve përkatëse kanë dhënë rezultate tërësisht të ndryshme në funksion të vlerës kulturore të Teatrit Kombëtar, në një kohë shumë të shkurtër.
- Procesi i ndjekur në lidhje me vlerat historiko-kulturore të godinave të Teatrit Kombëtar si për shkak të historikut të tij, ashtu dhe të përfshirjes në qendrën historike të qytetit të Tiranës, nuk është trajtuar me kujdesin dhe seriozitetin e duhur.
- Gjykata vendosi se ligji bie në kundërshtim me respektimin dhe mbrojtjen trashëgimisë kulturore.¹²

Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se Kuvendi ka anashkaluar Këshillin Bashkiak në momentin e miratimit të ligjit. Kështu Kuvendi ka

⁸ Për më shumë shih Vendim nr. 29 datë 02.07.2021

⁹ Fillimisht ligji parashikonte se do të ishte Fusha sh.p.k ajo që do të ndërtonte Teatrin e ri Kombëtar, por pas kundërshtimit të aktoëve brenda vendit si artistëve, organizatave të ndryshme dhe Partisë Demokratike dhe Komisionit Europian, qeveria vendosi kriteret për të marrë pjesë në procedurë. Një ndër to është marrëveshja me pronarët.

¹⁰ Për më shumë shih nenin 11 të Kushtetutës

¹¹ Në vitin 2000 ministria e kulturës vemdosi fillimisht që në listën e trashëgimisë kulturore të ishte dhe godina e Teatrit Kombëtar. 5 ditë nga vendimi, ministria e nxorri godinën jashtë kësaj liste. Gjithashtu Teatri Kombëtar u vendos në mbrojtje të përkohshme dhe më pas institucionet ja hoqën këtë status. Për më shumë rreth historikut lexo vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 02.07.2021, faqe 41-44.

¹² Shih nenin 3 të Kushtetutës

ndërhyrë në këtë mënyrë në kompetencat e Këshillit, në kundërshtim me parimet e decentralizimit, qeverisjes vendore dhe ndarjes e balancimit të pushteteve.

Në përfundim Gjykata Kushtetuese ka analizuar dhe vendimin e qeverisë për kalimin e pronësisë së truallit të Teatrit Kombëtar drejt Bashkisë së Tiranës. Gjykata e gjen në kundërshtim me Kushtetutën një vendim të tillë, pasi ky i fundit nuk është bazuar në ligj.

Ajo argumenton se një vendim i tillë shkel parimin e hierarkisë së normave ligjore¹³

Komente:

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nxjerr disa probleme. Së pari çështja e teatrit Kombëtar solli për herë të parë një ligj, i cili i atribuohet një kompanie të caktuar. Ligji është akt formal të cilin e nxjerr organi legjislativ i shtetit (Parlamenti) dhe përmban tërësi të normave (rregullave) me të cilat rregullohet një fushë e caktuar e jetës në shoqëri. Nga ky përkufizim ne mund të nxjerrim dy konkluzione:

- Ligji prek të gjithë pjesëtarët e një shoqërie ose një pjesë të tyre.
- Ligji ka karakter të përgjithshëm dhe jo individual

Gjykata thekson se:

- **Një ligj i tillë si ai Teatrit Kombëtar shkel parimet e lirisë ekonomike**
- **Institucionet kanë dështuar të përcaktojnë saktë statusin e Teatrit Kombëtar**
- **Ekzistenca e një force politike e cila drejton të gjitha institucionet, sjell situata ku anashkalohen të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji**

⚠ Gjykata Kushtetuese refuzoi të shprehet për shembjen e Teatrit Kombëtar pasi kjo është jashtë kompetencës së saj.

Megjithatë në një analizë të vendimit, shembja e Teatrit është kryer pa patur një bazë ligjore, pasi vendimi i kalimit të truallit është i pavlefshëm. Kjo do të thotë se të gjitha vendimet e tjera të dala në bazë të saj janë të pavlefshme.

Vendimi i Kushtetuese do të shërbejë si bazë ligjore për gjykatën administrative e cila do të shqyrtojë ligjshmërinë e shembjes së Teatrit Kombëtar.

¹³ Për më shumë shih nenin 116 dhe 118 të Kushtetutës



Kushtetutshmëria e vendosjes së pragut të herësit në Kodin Zgjedhor

Faktet:

Kuvendi në korrik të 2020 miratoi disa ndryshime kushtetuese përmes të cilave :

- Sistemi zgjedhor është proporcional me konkurim rajonal
- Ka një prag kombëtar, por kjo përcaktohet në Kodin Zgjedhor
- Votuesit kanë mundësi të zgjedhin të paktën dy të tretën e kandidatëve për deputetë.
- Kandidatët për deputetë propozohen nga votuesit ose partitë politike, duke ja lënë Kodit Zgjedhor rregullimin e koalicioneve.

Në bazë të tyre, parlamenti miratoi dhe një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor.

Partitë Bindja Demokratike dhe Lëvizja Demokratike Shqiptare i kërkuan Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë nenin 163 të Kodit të ri Zgjedhor, i cili parashikonte mënyrën e shpërndarjes së mandateve.

Herësi është pjesëtimi i numrit të votave të vlefshme në një zonë zgjedhore me numrin e mandateve që shpërndahen në atë zonë.

Sipas tij, nëse një kandidat për deputet që nuk është pjesë e listës fituese ka marrë më shumë vota se herësi ai automatikisht merr mandat deputeti. Në rast se herësi është më i madh se 10 mijë, kandidatit i mjafton të marrë mbi 10 001 vota për të marrë mandatin.

Vendimi i Gjykatës¹⁴:

Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se votimi parapëlqyes është një risi në sistemin zgjedhor shqiptar, duke i dhënë mundësi qytetarëve të përzgjedhin kandidatin e tyre të preferuar.

Megjithatë gjykata ka nxjerrë në pah disa elementë:

¹⁴ Për më shumë shih Vendim nr. 28 datë 30.06.2021

- Votimi parapëlqyes zbatohet për të gjithë listën e kandidatëve. Ai e ndan këtë të fundit në dy pjesë (lista fituese dhe jofituese) . Gjykata argumenton se vota parapëlqyese do të ri-rendisi kandidatët në të dyja pjesët e listës.
- Gjykata argumenton se prania e herësit balancon vlerën e votës së qytetarëve dhe rolin e partive politike.
- Megjithatë ajo gjen se ekzistenca e një pragu prej 10 mijë votave, cenon të drejtën e qytetarëve për të votuar. Shumë qytete në vend kanë një numër të vogël zgjedhësish dhe nuk arrijnë të plotësojnë këtë herës. Kjo do të thotë se në ato zona pragu i përcaktuar për herësin është i pazbatueshëm për këto zona.

Koment:

Ky vendim i Kushtetuese shërben si orientim në lidhje me realizimin e të drejtës së votës duke parashikuar mekanizma si vota parapëlqyese apo prezenca e herësit.

Edhe pse herësi shihet si balancues mes votës së qytetarit dhe partive politike, ai duhet të garantojë barazinë e votës së tyre në çdo qytet. Vendimi duhet të shërbejë për parlamentin e ri që të krijojë një prag të pranueshëm dhe të drejtë.

Tashmë Kuvendi duhet të miratojë një prag të ri për herësin, pasi kjo dispozitë është shfuqizuar.

Kështu Kuvendi duhet të marrë për bazë zgjedhjet e këtij viti për të bërë një analizë të votave të vlefshme në secilin prej qarqeve, numrin e votuesve dhe më pas të vendosë një prag për herësin i cili zbatohet në të gjithë vendin.



Kushtetutshmëria e ndryshimeve të ligjit për policinë

Faktet:

Në shkurt të 2020, qeveria propozoi disa ndryshime në ligjin për policinë, të cilat i jepnin policisë së shtetit të drejtën të përgjojë dhe gjurmojë qytetarët vetëm me vendim të saj për një periudhë deri në tre muaj, pa kërkuar fare leje nga gjykata.

Në tetor të 2020, Kuvendi miratoi ndryshimet, duke u tërhequr nga ky propozim duke parashikuar se policia nuk do të përgjojë por vetëm do të mbikqyrë.

Më 24 tetor Presidenti Ilir Meta, e ktheu ligjin në Kuvend me argumentin se shkel parimin e ndarjes së pushteteve dhe cenon pavarësinë e prokurorisë.

Me 18 shkurt 2021, Avokati i Popullit i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë kompetencat ligjore të policisë, të cilat i japin të drejtë të mbikqyrë dhe gjurmojë qytetarët.

Vendimi i Gjykatës ¹⁵:

1. Ndryshimet e miratuara nga Kuvendi, cenojnë të drejtën për një jetë private¹⁶
2. Ndryshimet nuk respektojnë kriteret e nenit 17 të Kushtetutës¹⁷. Gjykata argumenton se ligji parashikon të drejtën që do të kufizohet por nuk parashikon procedurat. Neni 17 përcakton se ligji duhet të përmbajë të drejtën që kufizohet dhe procedurën se si do të kufizohet, kriteret që duhen përmbushur etj.
3. Gjykata pohoi se pavarësisht se termi juridik u ndryshua nga përgjim në mbikqyrje, veprimet e policisë sipas ndryshimeve mbeten të njëjta.

¹⁵ Për më shumë lexo Vendim nr. 30 datë 05.07.2021

¹⁶ Shih nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës

¹⁷ Neni 17: 1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Gjykata argumenton se ligji nuk përcakton rastet dhe veprat penale kur mundet që individi të gjurmohet e mbikqyret si asnjë organ kontrollues tjetër siç është prokurori. Kjo e bën atë arbitrar.
5. Gjykata shprehet se janë bërë disa parashikime për kufizimin që i vendoset së drejtës së jetës private, këto parashikime nuk janë formuluar në mënyrë cilësore.

Komente:

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shfuqizoi ndryshimet të cilat nëse do ishin ende në fuqi do të përbënin rrezik për jetën private të qytetarëve. Me anë të këtij projektligji, qeveria i kalonte kompetencat e prokurorisë, Policisë së Shtetit, organ në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Nga ana tjetër ligji shkelte një nga parimet më të rëndësishme të vendit, atë të ndarjes së pushteteve. Ai anashkalonte prokurorinë dhe gjykatën si institucione mbikqyrësi në procesin e përgjimit e mbikqyrjes dhe i jepte një mjet të fillë policisë, e cila është në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Kushtetutshmëria e nenit 262 të Kodit Penal, në lidhje me lirinë e tubimeve

Faktet:

Në mars të 2017, gjatë vizitës së Kryeministrit Edi Rama në Shkodër, një grup të rinjsh, mes të cilëve edhe shtetasi me inicialet A.B., i angazhuar politikisht, protestuan ndaj kësaj vizite. Sipas raportit të autoriteteve policore, këta persona kanë tentuan të dalin në rrugë, por nuk u lejuan nga forcat policore.

Oficerët e Policisë Gjqësore përpiluan një procesverbal dhe mbi bazën e materialeve të grumbulluara për ngjarjen dhe bënë referimin e këtij fakti në prokurori.

Prokuroria e Shkodrës depozitoi në gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të A.B., për kryerjen e veprës penale

“Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”.¹⁸

Çështja shkoi më pas në gjykatën e Apelit Shkodër, ku kjo e fundit vendosi të pezullojë gjykimin dhe t’ja dërgojë Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim nenin përkatës.

Vendimi i Gjykatës¹⁹:

- i. Gjykata u shpreh së në Kodin Penal përdoret fjala leje ndërsa në ligjin për tubimet²⁰ përdoret fjala njoftim. Kjo krijon pasiguri juridike të qytetarët, pasi fjalët kanë kuptim të ndryshëm.
- ii. Kjo krijon një situatë në të cilën nismëtarët e një tubimi nuk e dinë nëse duhet të marrin leje apo duhet thjesht të njoftojnë organet përkatëse.
- iii. Gjykata Kushtetuese argumenton se ky nen cënon lirinë e tubimit.

Komente:

Ky vendim i Gjykatës ka theksuar një element të rëndësishëm në lidhje me lirinë e tubimit: Organizatorët nuk duhet të marrin leje për të organizuar një protestë pasi kjo cënon në thelb lirinë e tyre, por ata duhet të njoftojnë me shkrim organet kompetente.

Në këtë mënyrë realizohet dhe e drejta e një grupi qytetarësh dhe ruajtja e rendit publik në vend.

Kujtojmë se neni 262 është përdorur gjërësisht në të kaluarën për të arrestuar organizatorë apo pjesëmarrës në një tubim apo protestë.

Tashmë Kuvendi do duhet të miratojë një dispozitë të re në Kodin Penal, duke u bazuar në atë që ka referuar Gjykata Kushtetuese. Kjo do të thotë se duhet që qeveria, deputetët apo 20 mijë zgjedhës të nisin procedurën ligjvënëse për të plotësuar këtë dispozitë.

Norma e re duhet të jetë në përputhje dhe me ligjin për tubimet. Vendimi i Gjykatës duhet të shërbejë për deputetët në mënyrë që norma e re të respektojë të drejtën e tubimeve.

¹⁸ Shih nenin 262 të Kodit Penal

¹⁹ Për më shumë lexo Vendim nr. 24 datë 04.05.2021

²⁰ Shih Ligjin nr. 8773/2001

Gjetjet kryesore te analizës:



Prej rifillimit të funksionit të GJK janë marrë 30 vendime, nga të cilat ka shfuqizuar disa prej ligjeve të Kuvendit si rasti i ligjit special të Teatrit Kombëtar, ligjit për policinë.



Gjykata Kushtetuese sqaroi se Presidenti nuk ka rol honorifik në emërimin e një ministri, por verifikues. Kjo do të thotë se ai ka të drejtë të mosdekretojë një ministër



Gjykata Kushtetuese kritikoi të gjithë institucionet për mospërcaktimin e statusit ligjor të Teatrit Kombëtar dhe shfuqizoi vendimin për kalimin e truallit të tij në pronësi të Bashkisë si dhe ligjin special për ndërtimin e tij.



Gjykata shfuqizoi pragun 10 mijë për herësin në Kodin e ri Zgjedhor, duke i hapur rrugë përcaktimi të një herësi më të ulët.



Gjykata shfuqizoi të drejtën e policisë për të përgjuar qytetarët pa vendim gjykate



Gjykata shfuqizoi detyrimin e përcaktuar në Kodin Penal për të marrë leje në polici.

Rekomandime/perfundime



Kuvendi duhet menjëherë të ndërmarrë masat për të miratuar ndryshimet në Kodin Penal.



Kuvendi duhet të miratojë një prag më të ulët për herësin.



Në tetor pritet të dalë dhe opinioni i Komisionit të venecias në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve vendore me 30 qershor 2019. Gjykata duhet me emergjencë të japë një vendim në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu GJK duhet të shprehet në lidhje me kërkesën e Kuvendit për shkarkimin e Presidentit Meta.



Gjykatat administrative duhet të shqyrtojnë me shpejtësi ligjshmërinë e prishjes së Teatrit Kombëtar.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE